

**SHEMBULLI THJESHTON ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR 23. DATË 20.11 2012 PËR
“PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE
NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË”**

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale zhvilloi kontrollin administrativ ex officio (kryesisht) pranë kontrolluesit “Klinika shëndetësore XXX” në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat e subjekteve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe masat e sigurisë në lidhje me to.

Nga kontrolli administrativ u konstatua se:

Për kategorinë “pacientë” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale si emri, mbiemri, data e lindjes, gjinia, mosha, numri i telefonit, adresa, diagnoza, të dhëna mbi alergjitë e mundshme dhe grafi.

Këto të dhëna mblidhen nga personeli i mjekëve përmes plotësimit të kartelës (modulit) për mbrojtjen e privatësisë së pacientit. Për sa i përket të dhënave të sipërcituara përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi se mblidheshin me pëlqimin e pacientëve dhe ky pëlqim provohej në formë të shkruar me anë të kartelës (modulit) për mbrojtjen e privatësisë, por në përputhje dhe zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, gjatë kontrollit u konstatua se të dhënat personale të klientëve mbaheshin për një afat të pacaktuar. Për sa i përket kohës së ruajtjes së të dhënave personale sipas shkronjës d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ndryshuar, përcaktohet se të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

Në këtë rast duhet të respektohen afatet e parashikuara në kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.

Kontrolluesi ka të administruara në kompjuter disa dosje me emër, mbiemër të pacientëve. Të dhënat në këto dosje ruhen që prej krijimit të klinikës. Administrator i këtij sistemi është vetë kontrolluesi dhe hapja e kompjuterit bëhej me anë të një fjalëkalimi dhe aty kishin akses 5 mjekë. Në këtë kompjuter secili nga mjekët kur aksesonte këto dosje nuk hynte me një fjalëkalim hyrës të ndryshëm nga njëri-tjetri me qëllim identifikimin e tij gjatë përdorimit të të dhënave të pacientëve. Aksesit nëpërmjet emrit/fjalëkalimit duhet të jetë i personalizuar për çdo përdorues.

Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme për sigurinë e të dhënave personale që përpunon.

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative dhe për pasojë Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale rekomandon:

1. Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit (në zbatim edhe të Udhëzimit nr. 23 datë 20/11/2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”. (Kreu VI,

pika 1) e) - nxjerr dhe nënshkruan një rregullore të brendshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;

2. Të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Të respektohen afatet e parashikuara në Kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.